



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1227/2 prot

Pukë, më 28 . 07 . 2025

VENDIM
Nr. 21 , datë 25 . 07 . 2025

„PËR RISHQYRTIMIN E VKB NR.66 DATE 23.10. 2019 PËR MIRATIMIN E HEQJES NGA FONDI PYJORE PUBLIK TE SIPERFAQJES 0.105 HA QE DO PERDORET PER NDERTIMIN E HEC KORTHFULA BASHKIA PUKË“

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ne Ligjin nr.43 date 30.04.2015 “Per sektorin e energjise elektrike ” i ndryshuar , ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 “Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullisor publik.”, V.K.M-ve nr 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit , procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore 1374, date 10.10.2008 “Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhen dryshimin e destinacionit te fondit kullisor” Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullisor publik”, nga ana Drejtoria Pergjegjese per pyjet dhe Kullotat, me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak pas shqyrtimit :

VENDOSI:


1. Te miratoje pelqimin per heqje nga fondi pyjore te siperfaqjes 0.105 ha ne ekonomine pyjore Gomsiqe, e cila ndahet:
 - parcela nr 24 siperfaqja 0.05 ha zona kadastrale 2992 pasuria nr.358/6,
 - parcela nr.30/a siperfaqja 0.005 zona kadastrale 2509 pasuria 748/3
 - parcela Nr 32/a siperfaqja 0.05 zona kadastrale 2509 pasuria nr.763/2, e trajtuar ne Vendimin e Keshillit bashkise Puke Nr. 66 date 23/10/2019 .
2. Precedura dhe vlere e heqjes nga fondi pyjore bazohen ne V.K.M-ve nr 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se

perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Drejtoria e Menaxhimit te Pyjeve e kullotat,dhe Bujqesine.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , neni 55, pika 6.
5. Vendimi u shpall me datë 28.07. 2025.
Vota të vlefshme gjithsej 8
Vota pro 8 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon **GJOKA**



H. Terburg
F. Dooley
Ben W. King
[Signature]
REPUBLIC



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Shkodër, më 01.08.2025

Nr. 495/1 Prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 21, datë 25.07.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë



KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, të ndryshuar, neni 25, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 48 dhe 49, të VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncensionit”, të ndryshuar, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 50, shtojca 48, të VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore”, lidhja 1, tabela 10, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22, shkronja “f”, të lejes së lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë me nr. Serial 000145, nr. 242 prot., datë 29.04.2021 “Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor”, shqyrtoi VKB Pukë nr. 21, datë 25.07.2025 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 66, datë 23.10.2019 Për miratimin e heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.105 ha, që do të përdoret për ndërtimin e HEC Korthpula, Bashkia Pukë”, të ndarë me sipërfaqe 0.05 ha, EP Gomsiqe, parcela nr. 24, ZK 2992, pasuria nr. 358/6, me sipërfaqe 0.005 ha, EP Gomsiqe, parcela 30/a, ZK 2509, pasuria 748/3, me sipërfaqe 0.05 ha, EP Gomsiqe, parcela nr. 32/a, ZK 2509, pasuria nr. 763/2.

Për sa trajtuar, Prefekti pas plotësimit të dokumentacionit ju autorizon procedimin, por duke ju sjellë në vëmendje përditësimin e statusit juridik të pasurive të trajtuara në vendim. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGON